



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.4.2022, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Pëllumbi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare KESH (Agjencia e zbatimit të projektit) dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës”.
(Komision për dhënie mendimi)

Marrin pjesë:

Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Fadil Nasufi, Laert Duraj, Tatiana Piro, Ilir Ndraxhi, Baftjar Zeqaj, Anduel Tahiraj, Ismet Beqiraj, Lefter Gështenja, Zef Hila, Xhelal Mziu, Flamur Hoxha Agron Duka dhe Nusret Avdulla.

Mungojnë:

Luljeta Bozo, Rahman Rraja, Fatjon Veizaj dhe Ramadan Likaj.

Të ftuar:

Kesjana Halili - Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Elona Mistrovica – Drejtore e Drejtorisë së Bashkërendimit dhe Sigurimit të Ndhmës së Huaj në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ilir Gjata - Këshilltar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Ilir Bejtja - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Enea Karakaçi - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave dhe Zhvillimit të Industrisë dhe Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Rudina Xhelilaj - Drejtor i Programeve të Zhvillimit në Fushën e Energjisë dhe Eficiencën e Energjisë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Fatos Bundo - Drejtor i Njësisë së Menaxhimit të Projekteve për Sigurinë e Digave (KESH sh.a)

HAPET MBLEDHJA

Arben Pëllumbi – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Pika e parë e rendit të ditës është miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit në datat 7 dhe 8 shkurt 2022, të cilat kanë ardhur në postën tuaj elektronike.

Ka ndonjë vërejtje nga kolegët për procesverbalet?

I konsiderojmë të miratuara.

Pika e dytë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare KESH dhe KfW-së, për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës”. Relator i këtij projektligji është zoti Anduel Tahiraj, kurse ne jemi komision për dhënie mendimi.

Të ftuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë janë zonja Kesjana Halili, drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit Publik, të cilës i uroj mirëseardhjen, si dhe zonja Elona Mistrovica, e cila nuk është prezente.

Nga Ministria e Infrastrukturës kemi të ftuar zotin Ilir Bejtja, zonjën Rudina Xhelilaj dhe zoti Fatos Bundo, të cilëve u uroj mirëseardhjen.

Kush nga ju do ta prezantojë projektligjin?

Fjala për ju, zoti Ilir.

Ilir Bejtja – Përshëndetje, të nderuar deputetë!

Kredia që ne marrim është në vazhdim të procesit të rehabilitimit të kaskadës së lumit Drin, që ka filluar më herët me HEC-in e Vaut të Dejës, më pas me riparimin e turbinave në Koman dhe tani jemi duke u marrë me agregatët dhe rrotat e punës në hidrocentralin e Fierzës.

Për nga rëndësia që ka ky projekt, pjesa e Fierzës është strategjike për të gjithë kaskadën për arsyen se është ujëmbledhësi më i madh që kemi, një nga prodhuesit më të rëndësishëm, që garanton, gjithashtu, edhe funksionimin normal të të gjithë kaskadës, si një balancues për të gjithë kaskadën.

Në këtë aspekt, rehabilitimi i hidrocentralit vjen si një kërkesë e domosdoshme (them hidrocentralit, sepse ajo është pjesa kryesore e punës e tij) pasi rrit kohën e punës edhe me 30 vjet të tjera pas këtij riparimi themelor që i bëhet agregatëve dhe rrotave punuese. Riparimi ka filluar 2 vjet më parë me rrotat e turbinave 1 dhe 3 dhe tani vazhdon me dy rrotat punuese të turbinave 2 dhe 4 dhe me pjesën e gjenerimit të të gjithë hidrocentralit.

Faktikisht, ai rrit eficiencën e prodhimit në hidrocentral me rreth 4%, redukton një humbje të verifikuar së fundi, për shkak edhe të amortizimit të rrotave të punës, me rreth 54 gigavat në vit, të cilat përkthehen afërsisht në 2 600 000 - 2 700 000 euro në vit. Pra, këtë e përfitojmë. Gjithashtu, rrisin edhe eficiencën e punës.

Është një hidrocentral i ndërtuar në vitet '74-'78 dhe tani ka ardhur momenti që me përmirësimet që u bëhen edhe pjesëve të turbinave të rritet edhe efienca në prodhim.

Kredia është në vlerën 40 milionë euro dhe shoqërohet edhe me dy grante, për të cilat ne do të vijmë një herë tjetër, pasi të miratohen nga qeveria, në masën rreth 10,35 milionë euro.

Me rehabilitimin e Fierzës ne mbyllim procesin e rinovimit të të gjithë kaskadës dhe të marrjes së një afati akoma më të gjatë sesa afati natyral i një HEC-i për të pasur energji me të njëjtën kaskadë.

Gjithashtu, ky investim kontribuon në reduktimin e kostove në mirëmbajtje, në reduktimin e emetimeve të karbonit, duke qenë se është vepra më e madhe prodhuese hidro në të gjithë Ballkanin, rrit sigurinë e furnizimit të vendit me energji elektrike, pasi në kushtet që jemi herë pas here mund të ndodhin defekte dhe mbetemi në mungesë prodhimi, rrit jetëgjatësinë me rreth 30 vjet, si dhe redukton kohën e mirëmbajtjes së agregatëve. Këto janë pak a shumë përfitimet që kemi nga ky projekt.

Pra, është një proces i domosdoshëm teknologjik për kaskadën.

Në kushtet që jemi nuk është nevoja të tregojmë cilat janë përfitimet, sepse kostot e prodhimit që ne kemi në kaskadë, duke pasur parasysh normën e amortizimit, janë 20 herë më të ulëta si prodhim sesa çmimet e tregut të energjisë. Është i vetmi aset që ka mundësuar deri tani që ne të mbajmë në kontroll çmimet e shitjes në tregun e rregulluar, por të ndihmojmë edhe ata që janë në tregun e pa rregulluar.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Faleminderit, zoti Bejtja!

Po, zoti Tahiraj.

Ilir Bejtja - Më falni, mund të thotë zonja edhe dy elemente për kostot?

Arben Pëllumbi – Po, patjetër.

Rudina Xhelilaj – Përshëndetje të gjithëve!

Sikurse e tha zoti Bejtja, huaja do të jetë në vlerën 40 milionë euro, do të ketë një maturim prej 26 vjetësh, një periudhë pa pagesë principali prej 6 vjetësh, ndërkohë që interesi fiks do të jetë i përcaktuar në momentin e disbursimit dhe do të llogaritet mbi bazën e ICAP euro, që është norma referencë ndërkombëtare, plus një marzh prej 0,55%.

Gjithashtu, huaja do të shoqërohet edhe me një tarifë menaxhimi, që është 1% e shumës së huas, e cila paguhet në momentin e parë të disbursimit të kredisë, pra vetëm një herë, dhe një komision angazhimi prej 0,25% në vit mbi shumën e padisbursuar të huas.

Faleminderit!

Arben Pëllumbi - Faleminderit!

Po, zoti Tahiraj.

Anduel Tahiraj – Përshëndetje të gjithëve!

Jemi në kushtet kur KESH-i kërkon të bëjë rehabilitimin elektro-mekanik të HEC-it të Fierzës. Rehabilitimi nuk ka si synim të rrisë fuqinë e instaluar të centralit, por që të minimizojë orët me defekt të punimit të agregatëve.

Siç e thanë edhe drejtuesit e ministrisë, në kaskadën e Drinit HEC-i i Fierzës ka një rol kryesor jo vetëm në prodhimin e energjisë elektrike, por edhe në koordinimin hidrik të të gjithë sistemit. Duke qenë se është ujëmbledhësi më i madh, do të ndikojë dhe do të bëjë koordinimin edhe në Koman dhe në Vaun e Dejës.

Nuk po futem në kushtet financiare të marrëveshjes, por po përmend pritshmëritë që kemi nga riparimi i HEC-it të Fierzës.

Ky riparim do të sjellë rritje të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i i Fierzës me të paktën 53 gigavatorë në vit, rritje të eficiencës në prodhimin e HEC-it të Fierzës me të paktën 4%, reduktimin e kohës së nevojshme për mirëmbajtjen e agregatëve, rritjen e disponueshmërinë së veprës, reduktimin e kostove vjetore për mirëmbajtjen periodike, kontributin në reduktimin e emetimeve të dioksidit të karbonit nga prodhimi i energjisë elektrike në rajon, rritjen e sigurisë së sigurimit të vendit me energji elektrike, si dhe rritjen e jetëgjatësisë së funksionimit të veprës me të paktën 30 vjet.

Mirëmbajtja e HEC-it të Fierzës është bërë për herë të fundit në vitet 2003-2007.

Unë nuk po futem në pjesën teknike, por po ju kërkoj miratimin e kësaj huaje për të pasur një sistem sa më të mirë energjetik në Shqipëri.

Gjithashtu, kam edhe dy pyetje, të cilat dua t'i konsultoj edhe me kolegët.

E para, në dijeninë time, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave, në datën 15.12.2021, ka kaluar edhe marrëveshja e grantit që mbështet këtë projekt. Duke qenë se nuk është e parashikuar në këtë hua që marrim, pse nuk e shqyrtojmë dhe e kalojmë së bashku me këtë?

E dyta, ta kalojmë së bashku me këtë.

Së dyti, relacioni nuk shprehet për përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm, siç e parashikon neni 69 i Rregullores së Kuvendit. A mund të kemi një informacion në lidhje me objektivat e përmbushura?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Tahiraj!

Zoti Bejtja, nëse dëshironi, mund të filloni me përgjigjet, për të vijuar pastaj kolegët e tjerë.

(Deputeti Bushati ndërhyrje pa mikrofon.)

Helidon Bushati – ...të bëj një ndërhyrje, për procedurë?

Atëherë, po shihja panelin e të ftuarve dhe, me gjithë respektin për zotin Bejtja, si dhe për kolegët e tjerë, unë mendoj se duhet t'i japim fund kësaj procedure, ku drejtorët e sh.a.-ve publike nuk vijnë vetë këtu, por sjellin punonjës të nderuar, nëpunës të nderuar. Këtu duhet të jenë drejtuesit e institucioneve.

E kuptoj që jo gjithmonë ministrat mund edhe të mos jenë për efekt të axhendës së tyre, por drejtorët e ndërmarrjeve publike e kanë për detyrim, të nderuar kolegë, që të jenë aty, së bashku me zëvendësministrin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Prandaj, ju kërkoj juve, në cilësinë e kryetarit, të sekretarit, që herë të tjera, kur të ketë për të diskutuar jo vetëm pjesë të huas, por edhe elementet e tjera të cilat afektojnë (dhe afektojnë në kuptimin e interesimit, pra janë të interesuar) sh.a.-të publike, drejtuesit e sh.a.-ve, administratori, duhet të jetë me patjetër prezent këtu, sepse ka edhe pyetje për të cilat duhet të mbajnë edhe përgjegjësi politike, pavarësisht se është zëvendësministri, po edhe tekniko-politike.

Prandaj, procedurës së sjelljes këtu të nëpunësve të sh.a.-ve duhet t'i japim fund njëherë e mirë. Duhet të jetë prezent drejtori. Pastaj, padyshim që drejtori vjen me stafin ndihmës. Nuk ka asnjëlloj problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por drejtorët duhet të jenë me patjetër këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Pëllumbi – Ju falënderoj, zoti Bushati!

Në fakt, ne ftojmë për të mbrojtur projektligjin atë që është propozuesi i atij projektligji. Pastaj, se me kë paraqitet propozuesi për të bërë një mbrojtje më të mirë, e ka në dorë vetë.

Në rast se ne kemi nevojë që të vijë dikush specifikisht në një takim, mjafton që ta kërkojmë dhe ne i drejtohem që të jetë prezent edhe dikush tjetër. Por nuk mundemi dot t'ia imponojmë. Ne kemi për detyrë të kemi ministren ose zëvendësministrin që të mbrojë projektligjin, por në rast se na duhet që të jetë edhe dikush tjetër, pa asnjëlloj problem, kur të

bëjmë ftesën, e bëjmë edhe nominalisht për dikë, që mund të jetë edhe drejtori i një sh.a.-je. E zgjidhim, nuk është ndonjë problem.

Faleminderit!

Helidon Bushati – Atëherë, për efekt të diskutimit të sotëm, fatmirësisht, pothuajse ato kryesoret ose, më mirë të themi, gjashtë sh.a.-të kryesore, ato që quhen “strategjike publike” janë nën kompetencat e Ministrisë së Transporteve dhe të Energjetikës, ku tri janë nga transportet dhe tri të tjera nga energjetika.

Kështu, e gjej me vend, meqenëse prezent është zëvendësministri, që t’ia transmetojnë edhe titullarit se grupi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...i deputetëve të opozitës kërkon që sa herë vjen zëvendësministri apo ministrja, të jetë i shoqëruar nga administratori përkatës i një prej këtyre gjashtë shoqërive. Padyshim bëhet fjalë vetëm për kompanitë strategjike publike, jo për çdo kompani.

Në rregull, zoti Bejtja?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Bushati!

Atëherë, zoti Bejtja, kjo është një kërkesë e deputetëve të opozitës që në çdo rast, kur ju apo zonja ministre do të jeni këtu dhe do të kemi të bëjmë me një çështje që lidhet me kompanitë strategjike publike, të jetë prezent edhe drejtori apo drejtoresha përkatëse.

Faleminderit!

Vazhdojmë me përgjigjet, zoti Bejtja.

Ilir Bejtja – Patjetër, do ta transmetoj këtë, por do ta kemi edhe në vëmendje se çdo herë që do të kemi projekte që lidhen me ndërmarrje specifike të jenë edhe administratorët.

Në fakt, ata nuk kanë dijeni që do të duhej të ishin. Domethënë, grupi është strukturuar siç thatë ju, ftesa ka ardhur në ministri, dhe ne jemi... Domethënë, zoti Bundo vjen nga KESH-i dhe është drejtor i një projekti, në fakt.

Megjithatë, herë tjetër do ta kemi parasysht.

“Pse nuk ka ardhur granti?”, ishte pyetja e parë. Ato janë të ndara. Granti nuk shkon për projektin në fjalë. Projekti është i hartuar, është në vazhdim. Granti shoqëron kredinë dhe qëllimi i përdorimit nuk është me patjetër i lidhur me objektin e kësaj kredie.

Po të shikoni, edhe në relacionin mbështetës, granti nuk përmendet. Atë e thashë unë që është shoqëruar i kredisë në kuadrin e marrëveshjes, *accord*, që ne kemi me qeverinë gjermane. Në përgjithësi, çdo kredi e kemi të shoqëruar edhe me grante, të cilat përdoren sipas interesave të qeverisë.

“A është garantuar qëndrueshmëria?”, ishte një pyetje tjetër. E thashë në një nga argumentet se garanton rritjen e qëndrueshmërisë mjedisore, duke qenë se kontribuon në uljen e emisionit të karbonit. Pra, çdo kilovat shtesë që ne arrijmë të rikuperojmë nga një projekt energjie, direkt dhe indirekt, ndikon në përmirësimin e mjedisit, pasi na duhen më pak energji të bazuara në fosile.

Ne importojmë pjesën kryesore, domethënë atë që nuk është nga burimet hidro dhe si energji e blerë në bursë nga importi nuk garantohet asnjëherë qëndrueshmëria, sepse atje shitet çdo lloj energjie. Për këtë arsye themi se targeti ynë i prodhimit brenda vendit për momentin është 100% energji e pastër.

Në kuptim të konsumit, jemi rreth 35,2% nga 38%, që është targeti kombëtar. Kemi përmirësuar në total rreth 0,6%, sepse ndërkohë që ka qenë 34,6%, jemi 35,2%. Kjo lidhet edhe me rritjen e automjeteve në transport, të cilat përdorin më pak karburante ndotëse, sidomos ato që lidhen me bujqësinë, që përdoren për makineritë e rënda (nafta D1) ose me peshkimin apo me të tjera vende në industri, ku përdoren produktet e rënda të naftës, siç është mazuti dhe solari. Zbutja, ulja e këtyre, ka rritur përqindjen e konsumit të energjive të rinovueshme në totalin kombëtar të konsumit. Ndërsa prodhimin për momentin vazhdojmë ta kemi 100% të pastër.

Në të ardhmen do të jemi përsëri brenda targeteve. Targeti ynë kombëtar është mbi 20,9%, që ne duhet ta ulim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

20,9% në total. Domethënë, kaq e kemi objektivin për uljen e emisionit të karbonit deri në vitin 2030. Kjo lidhet kryesisht me transportin.

Nga ana tjetër, për energjinë do të kemi një periudhë prej rreth 2 vjetësh, ku do të prodhojmë energji të bazuar në diesel me dy platforma të lëvizshme, të cilat po i instalojmë në Treport të Vlorës. Ato do të kompensojnë periudhën kur ne do të fusim në punë TEC-in e Vlorës, të bazuar në gaz natyror, i cili konsiderohet në politikat e reja qeverisëse të Komunitetit Europian të Energjisë si burim i pastër.

A vazhdon gazi natyror të konsiderohet burim i përdorshëm për prodhimin e energjisë? Mbështeten edhe investimet për prodhimin e energjisë elektrike me gaz deri në vitin 2030. Pas këtij viti, sipas *roadmap*-it, pra planit të dekarbonizimit për të gjithë Europën, nuk do të ketë më investime për prodhimin e energjisë të bazuara në fosile të lëngëta, të gazta ose të ngurta dhe do të fillojë demontimi i tyre, duke nisur nga karbonet e ngurta (që janë qymyret, kokset), më pas të lëngshmet dhe për të përfunduar në vitin 2050 me mbylljen e të

gjithë prodhuesve të bazuar në karbon. Ky është targeti final i hapësirës europiane, jo vetëm i BE-së, por i të gjithë kontinentit europian.

Ne jemi palë kontraktore në Komunitetin e Energjisë dhe për këtë arsye jemi në të njëjtën rrugë, në të njëjtën gjurmë me të gjitha vendet anëtare.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Bejtja!

Po, zoti Bushati.

Helidon Bushati – Atëherë, unë do të filloj me disa pyetje dhe do të bëj ndoshta një ndërhyrje të fundit pasi të mbarojë seanca e pyetjeve.

Pa dyshim, pjesa e huas për një sh.a. ka nevoja të ndryshme për efekt të punës, por së pari mendoj që duhet të kishte një argumentim, për sa i përket menaxhimit tekniko-financiar të shoqërisë në përgjithësi. Kjo duhet të ishte baza për të kërkuar pastaj një kredi, që rrit akoma më shumë borxhet, jo aq sa të OSHE-së (se do vij edhe te pyetja që ka lidhje me borxhet e OSHE-së), por të vetë KESH-it.

Dua që ta filloj me një citim nga raporti i ERE-s i vitit 2021, i cili thotë: “ERE evidenton se rezerva energjetike në fund të muajit maj të vitit 2021, ka rezultuar në nivelin maksimal prej 1520 giga dhe në fund të muajit gusht kjo rezervë energjetike ka shkaktuar në 628 giga” (domethënë është ulur shumë). “Kjo ka shënuar një rënie të ndjeshme dhe të shpejtë”, thotë ERE. Këtu mbërrimë te një element, që edhe ju e përmendët, pjesa e çmimit të rregulluar dhe çmimit të parregulluar. Domethënë nga 5,4 terra që prodhon KESH-i, 3,9 e ka detyrim t’ia japë OSHE-së, ndërkohë 1,5 e shet në treg të lirë me 40 deri 45 euro siç e ka shitur dhe në të njëjtën periudhë po OSHE-ja, shoqëri aksionare shtetërore, po nën kompetencën e Ministrisë së Energjetikës e ka blerë me 205 euro.

Tani, zoti Bejtja, edhe në cilësinë e zëvendësministrit, përfaqësuesit të kësaj qeverie, edhe si njohës i sistemit, pyetja për këtë pikë është: pse shteti ka pasur këtë humbje, kur dy shoqëri aksionere shtetërore në të njëjtën periudhën njëra shet 1,5 tera me 42-45 euro dhe tjetra blen energji me 205 euro? Janë të dyja shoqëri aksionere dhe nuk kanë as njëllor limiti, sepse këtu hyjnë brokerat pastaj, që ju i njihni shumë mirë. Për shembull, i njëjti broker, Helidoni sh.p.k, e blen te KESH-i me 42 euro dhe në pak kohë ia kalon OSHE-së me 205 euro. Këtë duhet të dinë qytetarët. Kjo është pyetja e parë.

Kjo ka lidhje edhe me keqmenaxhimin e kasakadës, për të cilën do të kaloj te pyetja e dytë. Sipas rregulloreve të KESH-it, kur nivelet janë maksimale, në muajt maj –shtator, nuk shitet energji në tregun e lirë, pra, mbahen kuotat maksimale për efekt të sigurisë energjetike, ndërkohë ka ndodhur që kuotat kanë rënë ndjeshëm në muajt qershor-korrik- gusht. Në qoftë se doni, ju jap edhe nivelet, por ju i dini, kanë rënë shumë më tepër nën regjimin mesatar të

shfrytëzimit. Dua të di, pse ka ndodhur ky keqmenaxhim, i cili po sjell këto problematika që kemi ne sot?

E treta, të gjithë duhet të dimë që turbinat e mëdha të hidrocentraleve janë ndërtuar qëkur është ndërtuar hidrocentrali. Ato prodhohen nga prodhuesit e huaj në bazë të disa parametrave teknikë dhe janë të prodhuara *ad hoc*, sipas hidrocentraleve për efekt të elementeve teknike. Turbinat kanë një cikël jetese, që shkon nga 30 në 40 vjet. Këtu u tha që remonti i fundit është bërë në vitin 2007. Tani, nga 2007-a jemi në vitin 2022, është një periudhë e konsiderueshme, prandaj kërkoni që të hidhet në remont hidrocentrali. Ky ishte konstatimi juaj. Pyetja është shumë e thjeshtë, meqenëse gjatë gjithë vitit 2021 të gjitha turbinat e Fierzës kanë punuar me kapacitet maksimal, si e kuptuat ju që ka nevojë për remont? A e kuptoni pyetjen? Domethënë, turbinat kanë punuar me maksimumin e orëve të lejuara. A ma shpjegoni dot, që, duke mos pasur asnjë defekt asnjëra nga turbinat, si e kuptuat ju që duhet të bëni remontin sot? Kur remonti i fundit është bërë në vitin 2007, dhe sipas parametrave teknikë duhet bërë një herë në 30 vjet, a mund të ma shpjegoni këtë gjë nga ana teknike?

Drejtorit të KESH-it, do t'ia çoj me letër pyetjen, se dua të di edhe regjimin me të cilin ka punuar hidrocentrali. Ai duhet të ishte këtu sot, por mbase drejtori i sigurisë së digave ka të dhëna për këtë, se dua të di regjimin, sa ka punuar këto kohë hidrocentrali, apo sa energji kanë prodhuar këto kohë secila nga turbinat. Dua të di edhe nëse ka pasur probleme apo nuk ka pasur probleme. Këto janë pyetje teknike, që do t'i shtjellojmë.

Kalojmë te pyetja tjetër, për sa u përket elementeve financiare. Ne këtu si komision duhet të dinim se cili është borxhi afatshkurtër? Cili është borxhi afatmesëm? Cili është borxhi afatgjatë i KESH-it? Si e ka parashikuar KESH-i shlyerjen e këtyre borxheve? Ju do të më jepni përgjigje, por pa dyshim do t'ia çoj në mënyrë të detajuar pyetjet edhe drejtorit të KESH-it, që të na i sjellë përgjigjet me letra, se këtu të gjithë flasim me letra.

Kam një pyetje tjetër që ka lidhje me pyetjen e më përparshme. Situata sot në sistemin elektro-energjetik, për sa u përket elementeve financiare është një ekspozim ndaj borxhit i OSHE-së, tashmë në vlera, dikush thotë 800, dikush thotë 1 miliardë euro, domethënë është një ekspozim shumë i madh ndaj sistemit bankar. Në këto kushte, ka ndodhur që nga janari e më pas të gjitha blerjet e energjisë eklektike i ka marrë KESH-i, ndërkohë që më përpara kanë qenë të OSHE-së. Zoti zëvendësministër, më shpjegoni pse këto blerje do të bëhen tashmë nga KESH-i? Mos vallë kjo ka lidhje me faktin që OSHE-ja nuk mund të kreditohet më? Sepse nuk ka më institucione financiare që e kreditojnë OSHE-në për efekt të tej- ekspozimit ndaj borxhit, por KESH-i ka ende disa limite për të marrë

borxhe dhe këto borxhe do të shërbejnë për blerjen e energjisë, që ka ardhur si rezultat i keqmenaxhimit po të KESH-it.

E fundit, e dua të qartë nga ju, zoti Bejtja, ky 40 milionësh do të shkojë për rehabilitimin e turbinave apo për blerjet e energjisë elektrike?

Faleminderit!

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Bushati!

Zoti Bejtja, do të përgjigjeni?

Ilir Bejtja – Do t'i marr me radhë.

Në lidhje me aftësinë paguese të KESH-it, e gjithë kredia mbulohet nga tarifa. Aktualisht KESH-i e shet me dy tarifa energjinë që prodhon dhe që blen, për grupin e OSHE-së, për shpërndarjet, për humbjet, sepse tani është përgjegjës edhe për blerjen e energjisë së prodhuar nga HEC-et private, për furnizimin e operatorit universal, FSHU-së, si dhe për furnizimin e konsumatorëve në tension të mesëm, ose nën tension të lartë, të cilët tashmë janë me çmim të liberalizuar, jo të rregulluar, por që nuk mund të gjejnë furnizues në tregun e lirë. Pra, e gjitha kjo është e futur në tarifë dhe kemi 2,6 lekë për pjesën e tregut të rregulluar dhe 12 lekë tarifa është për konsumatorët në tension të mesëm. E dyta është gjithmonë e lëvizshme në funksion të mishelës që bëhet me tepricat e prodhimit që ne kemi, pra që janë me kosto të ulët dhe atë që importohet. Kjo ka qenë mënyra e përballimit.

Lidhur me rezervën energjetike, në krahun tonë, nuk e di këndvështrimin tuaj, ne pretendojmë se në mënyrën më shkencore nuk është...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Varet si i lexon të dhënat. Është menaxhuar në mënyrë tejet shkencore, 100% kaskada dhe rezerva energjetike. Duhet të keni parasysh që ne nuk mund të mbajmë rezervë energjetike gjatë gjithë vitit, sepse edhe periudhën e kemi të lidhur me reshjet. Pra, nëse ne eksportojmë, eksportojmë gjatë periudhës mars-qershor kur ne kemi ujë dhe teprica uji në kaskadë. Në një vit hidrik të mirë prodhojmë shumë energji, shkojmë vetëm me kaskadën dikur rreth 27-28 milionë kilovat orë në ditë. Mesatarisht konsumimi nga marsi deri në qershor lëviz nga 13 milionë deri në 16 milionë kilovat/orë në ditë dhe gjithë teprica shkon për treg të lirë, pasi nuk mund ta hedhim dhe nuk kemi ku e rezervojmë, ose mund ta depozitojmë nëpërmjet marrëveshjeve që KESH futet me operatorët e tjerë në treg. Asnjëherë nuk ndodh që kur ne kemi prodhim energjie OSHEE-ja të importojë apo KESH-i vetë të importojë, pra, kur kemi prodhim të mjaftueshëm. Po marr si shembull vitin që jemi, që nuk është vit i mirë hidrik, ne importojmë nga 1 janari deri tani vazhdojmë dhe importojmë, sepse nuk e përballojmë dot nevojën e energjisë në treg me burimet tona. Ne i kemi

menaxhuar shumë mirë importet me prodhimet vendase, në mënyrë që të ecim me kosto sa më racionale për tregun dhe sistemin.

Diferenca në çmimi midis KESH-it dhe OSHEE-së. Nuk po merrem me konstatimin që dikush, Helidoni, bleu energji te KESH-i dhe ia shiti nesër OSHEE-së, pasi kjo nuk ndodh, sepse, së pari, nuk ka ku e ruan energjinë derisa ta blejë OSHEE-ja, energjia u ble sot, shitet sot, nuk shitet pas disa ditësh dhe, së dyti, ne kemi arritur në vitin 2021 të kishim rezervë ujore mjaftueshëm deri në fund të muajit qershor, ku thatësira ka filluar nga data 23 qershor dhe deri tani. Ne vazhdojmë të jemi në kushte shumë minimale prodhimi energjie, pra nuk kemi pasur reshje ose prurje. Muaji shtator ka qenë momenti i parë kur ne i ndiemë efektet e importit, kemi blerë energji me 96 euro megavati, ndërkohë që kemi vazhduar prodhimin e vendit për rreth 51-52% me rezervën energjetike që kemi pasur të krijuar deri në qershor. Muaji tetor vazhdoi me 102 euro megavati, është mbyllur në 10 ditshin e fundit me 123 euro megavati, kemi hyrë në muajin nëntor 162 euro, kemi bërë tri blerje dhe blerja e fundit është 212 euro megavati në nëntor dhe muaji dhjetor ka qenë i konsoliduar në kufijtë e 220-260 euro megavati në të gjitha blerjet që ka bërë OSHEE-ja. OSHEE-ja ka qenë ajo, e cila blinte energji për diferencat e energjisë që nuk merrte nga KESH-i. KESH-i nuk ka qenë asnjëherë i detyruar të furnizojë energjinë qoftë se nuk ka pasur, pra, ishte OSHEE-ja që blinte dhe tani, për efekt të menaxhimit më të mirë, qoftë financiar, qoftë të detyrimeve të palëve me njëra-tjetrën për furnizimin me energji, qoftë edhe të kontrollit më të saktë të të gjitha burimeve që ne kemi për të blerë dhe prodhuar kemi vendosur, në kuadrin e krizës energjetike, t'i kemi të gjitha, prodhim dhe blerje, të akomoduar ose të alokuara në KESH. Ndërkohë, OSHEE-ja vazhdon të gjithë aktivitetin e saj që lidhet me shpërndarjen, me furnizimin dhe me furnizimin e tregut të lirë.

I gjithë prodhimi menaxhohet nga prodhuesi. Kjo është zgjidhja që ne kemi gjetur, e cila na ka rezultuar zgjidhje më shumë se racionale. Pra, në vend që ne të kontrollojmë disa burime ku ne blejmë, kemi vetëm një burim ku blejmë dhe prodhojmë dhe të tjerët blejnë për pjesën që nuk arrijnë të marrin energji nga sistemi. Pra, nëse FTL-ja blen energji, ajo blen vetëm devijimet ditore që mund të mos jenë të parashikuar për shkak të ndryshimeve apo spontanitetit që ka kërkesa për energjinë në treg dhe, deri në momentin që doli VKM-ja, ajo ka blerë edhe energjinë e HEC-eve, të cilën e kanë përdorur në mënyrë racionale si kompani tregtare për furnizimin e humbjeve të sistemit të shpërndarjes. Pra, energjinë që kanë pasur me tepriçë në kohën që ajo prodhohet nga HEC-et e vogla janë munduar ta tregtojnë në treg, në mënyrë që të krijojnë kapital për të blerë në periudhën kur nuk ka prodhim. HEC-et e vogla janë të gjitha *run of river*, pra nuk kanë rezervë energjetike dhe punojnë kur ka ujë në

treg. Kjo ka bërë të mundur që FTL-ja për herë të parë në vitin që shkoi vetëm menaxhimin e humbjeve ta bëjë me 0% diferencën me atë që është prodhuar dhe atë që është menaxhuar nëpërmjet energjisë së prodhuar në vitin 2021.

Për vitin në vazhdim ne vazhdojmë të menaxhojmë akoma me shumë nikoqirllëk kaskadën, duke pasur parasysh edhe luhatjet e rënda që ka tregu i energjisë në tregun ndërkombëtar. Pra, ne kemi blerë edhe përtej mundësive që ne kemi për të prodhuar në momente që ka qenë e përshtatshme të blesh energjinë, me çmime 120-127 euro, dhe ndërkohë ashtu siç kemi prodhuar, kur energjia ka qenë 549 euro. Në datën 6 mars deri në datën 12 mars energjia ka qenë mbi 380 euro në mesatare dhe ka tre ditë kulminante, datën 6 me rreth 384 euro, datën 8 me 484 euro dhe datën 9 me 549 euro. Këto çmime kanë qenë me të vërtetë shumë të rënda për sistemin, humbnin shumë më tepër para sesa të përdorim kaskadën, edhe përtej mundësive që ne kemi pasur dhe kemi qenë gjithmonë në pritje apo në kontroll të mundësisë që kemi për t'u kombinuar me parashikimet e motit që kemi pasur.

Për dijeni, këshilli teknik i KESH-it dhe komisioni i plotave nuk mbledhet vetëm kur ka plota, por mbledhet në mënyrë periodike, pikërisht, për të marrë vendime kolegjiale. Vendimet nuk janë të drejtorit të KESH-it, por janë vendime të koordinuar në shumë dimensione, edhe me agjencinë e parashikimit të motit ne vazhdojmë të kemi nga dy burime parashikime, të cilat na tregojnë edhe ujërat e pritshëm që ne do të kemi, temperaturat e ngritura ose të ulëta që kemi, në mënyrë të kemi parasysh se sa do të ejnë prurjet. Parashikimet tona për prurjet janë dy javore dhe i kemi të sakta, pra, ne e dimë sa është në datën 1 deri në datën 17.

Diferencën e çmimit midis KESH-it dhe OSHEE-së e shpjegoja.

Lidhur me pyetjen: pse është keqmenaxhuar në vitin 2021. Në fund të vitit 2021 kemi rezultuar me 57 milionë dollarë fitim në KESH dhe ato para i kemi përdorur deri tani, sa pa filluar akoma disbursimi i mbështetjes buxhetore që ka dhënë qeveria, prej 8 miliardë lekësh për KESH-in. Disbursimi nuk ka filluar nga 1 janari, por ka filluar nga fundi i muajit mars.

Remont për kohë të shkurtër. Në vitin 2003 janë riparuar, nuk janë zëvendësuar, vetëm dy rrota pune. Në projektin që kemi filluar tani po i zëvendësojmë fare rrotat e punës. T'i riparosh është të fitosh një farë kohë dhe t'i zëvendësosh janë pjesë këmbimi shumë të rëndësishme. Ne kemi vendosur pajisje të reja, të cilat rezistojnë 30 vjet, kuptohet, me shërbimet teknike, të cilat janë të përcaktuara. Në këtë pikë, unë besoj se pyetja do të donte që ju të vinit ta shikoni në vend kartelën teknike dhe të shikoni sesi zbatohet procesi i mirëmbajtjes dhe i zhvillimit të shërbimeve që u bëhen aggregateve. Nuk ka shanse, sepse ne nuk kemi një veturë dhe të themi që sot po ikim në Durrës, sepse kemi një takim me rëndësi

dhe po e lëmë riparimin për nesër. Nuk ekziston. Ne jemi një ndërmarrje, e cila respekton të gjitha shërbimet teknike, që nga ato rutinë, riparimet e mesme e themelore dhe deri te zëvendësimet e pjesëve kur ato janë totalisht të amortizuara. Nuk bëjnë 40 milionë euro riparimi i 2 rrotave pune, por i gjithë projekti është 40 milionë euro. Pra, ka të bëjë me të gjithë agregatin e Fierzës, i cili po rishikohet.

Pyetja: a ndodhin defekte? Në vitin 2016, përtej këshillave teknike të grupit teknik, kemi guxuar të vazhdojmë punën gjatë gjithë muajit dhjetor, kur duhet të ishim futur në remont me 2 turbina të Fierzë, të cilat i kanë pasur fletët e çara. Pra, në çdo moment mund të dëmtohej turbina në mënyrë permanente. Kemi pasur fat, besuam dhe vazhduam. Riparimin e dy turbinave e kemi filluar në javën e parë të janarit. Kjo ka qenë mënyra e menaxhimit.

Kjo punë do guxim dhe guximin e kanë ata që e njohin situatën në mënyrë perfekte, nuk e kam unë, sepse nuk e njoh, por ata që punojnë atje, ata japin situatat dhe skenarët e mundshëm, që mund të ndodhin për një ndërhyrje teknike, mekanike, teknologjike që ne bëjmë në agregat.

Për sa i përket pyetjes se sa është borxhi i KESH-it, kur ne kemi filluar procesin kanë qenë 74 miliardë lekë në vitin 2015, pra borxhi ka qenë 8 herë dhe tani që flasim është 1,65.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në vlerë nominale duhet të jetë rreth 18 miliardë. Pjesa tjetër e borxhit, e cila ka qenë borxh i pamanaxheushëm, 365 ditë i provigjenuar plotësisht, por që nga viti 2017 me ndihmën e BERZH-it, është kthyer në kredi e KESH-it për OSHEE-në dhe shlyhet rregullisht 17,6 milionë euro në vit me dy këste. Njëri këst paguhet në tetor dhe kësti tjetër në prill, i cili vazhdon të shlyhet nga OSHEE-ja rregullisht. Kjo kredi është 22 vjet mes KESH-it dhe OSHEE-së, një marrëdhënie e ndërsjellët mes tyre. Pra, nga 8, që e kemi pasur raportin e kemi 1,65.

Jemi nën monitorim strikt dhe shumë rigoroz të BERZH-it, i cili përcakton edhe sa janë limitet që ne mund ta mbajmë tarifën të ulët. Nëse sot e kemi vendosur 2,6% tarifën për sistemin e rregulluar të tregut, kjo nuk është se kështu e vendosëm ne, por ka qenë në projektet tona të kredisë që kemi marrë për refinancimin e overdrafteve nga BERZH-i që në vitet 2016-2017 së bashku me planin e veprimit për përmirësimin e qeverisjes korporative.

Për pyetjen: sa e ka OSHEE-ja borxhin, unë i nxora tani, megjithatë do t'jua sjell edhe zyrtarisht. Kemi 33 milionë euro borxh të marra si kredi nga Banka Botërore, pra nga 60 që ishte, është realizuar 33 me projektet. Disbursimi i saj fillon vitin që vjen, sepse ka pasur periudhë *grace* në realizimin e projektit.

Kemi 70 milionë euro kredi afatshkurtër, nga e cila janë disbursuar 50 milionë për likuiditet dhe 20 milionë euro për investim do të lëvrohen, ka akoma për t'u lëvruar, është e miratuar nga BERZH-i. Kjo kredi është 5-vjeçare.

Kemi 20 milionë euro nga bankat e nivelit të dytë, si overdraft.

Kemi dhe mbështetjen e fundit që na ka dhënë qeveria, që është kredi, nuk është si në rastin e KESH-it mbështetje buxhetore, 10 miliardë lekë. Pra, rreth 80 milionë euro është totali i borxhit që ka OSHEE-ja.

I gjithë sistemi elektroenergjetik ka një total borxhi prej rreth 483 milionë eurosh. Ne paguajmë rreth 7,1 miliardë lekë në vit dhe nuk kemi mbetur mbrapa asnjë vit.

Pyetja: a është OSHEE-ja e besueshme në treg, fakti që ajo ka marrë 2 kreditë e fundit me nga 10 milionë euro në tregun e bankave të nivelit të dytë, pa vendosur garanci kolaterale, sepse rrjeti nuk mund të vendoset për kolateral, tregon që është më se e besueshme në treg. Në sistemim elektroenergjetik, meqenëse kolateralat janë pjesë e pronave që nuk mund të vendosen si kolateral nga shteti apo nga agjencitë e tij në asnjë rast, kreditë merren me garanci sovrane.

OSHEE-ja deri tani që flasim ka 2 kredi me nga 10 milionë euro nga 2 bankat të nivelit të dytë si overdrafte, pa garanci kolaterale dhe pa mbështetje sovrane.

Është një pyetje që do të doja të mos i përgjigjesha, sepse është më shumë si një akuzë: cili është destinacioni i kredisë, ju e dini shumë mirë që me kreditë nuk bëhet shaka, që të merren për të blerë agregate dhe të blejmë energji, kjo është jashtë çdo diskutimi dhe nuk ndodh. Nëse ju dini ndonjë rast para 2013 na e tregoni.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zoti Bejtja!

Zoti Bushati ka një replikë.

Helidon Bushati – Kam një replikë, sepse disa nga përgjigjet nuk përkonin me pyetjet që bëra. Unë e shpreha shumë qartë, zoti Bejtja, nuk ishte e nevojshme që të më tregonit se ka 2 lloje çmimesh, çmimin e rregulluar dhe çmimin për tregun e lirë. Pyetja ishte: përveç detyrimit që KESH-i ka ndaj OSHEE-së 3,9 terra, atë 1,5 terra përse duhet t'i shitet te privatit me 40 euro...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pastaj do të tregoj edhe për firmën Helidoni sh.p.k. Përse KESH-i në të njëjtën periudhë, zoti Bejtja, duhet të shesë në tregun e lirë me 40, 45 euro megavatin dhe në të njëjtën periudhë OSHEE-ja duhet ta blejë më 205 euro, kësaj pyetje nuk iu përgjigjet.

Ilir Bejtja – Kur ka ndodhur?

Helidon Bushati – Ka ndodhur vjet, zoti Bejtja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është me fakte, me letra. Pra, pse nuk i jepet e gjithë sasia OSHEE-së, sepse edhe KESH-it edhe OSHEE-së i intereson. KESH-i shet për të bërë 57 milionë, të cilave do t'i kthehem në fund kur të marr fjalën, për të bërë tenderë, por edhe OSHEE-së i intereson për të blerë te klientët e saj. E para.

E dyta, ju thatë tani kemi gjetur zgjidhjen optimale, ku janë përqendruar te KESH-i të gjitha blerjet, këtë e konstatova edhe unë. Pyetja ime ishte: pse, zoti Bejtja, e bëtë sot, sepse deri tani u keqmenaxhuan, u abuzua me dhjetëra miliona euro, dhe tani që “ju erdhi thika në koc”, thotë populli, i përqendruat. Kjo është pyetja që duan të dinë kolegët këtu, por edhe qytetarët.

E treta, është një pyetje që jua kam bërë edhe përpara 3 muajsh, nëse nuk gaboju, që nga janari KESH-i po bën rolin e FTL-së, po blen energjinë vetë për me ia dhënë FSHU-së dhe të tjerëve, këtë FTL-në që ju e keni mbrojtur shumë, zoti Bejtja në tetor, a do të më thuash për çfarë nevojitet të ekzistojë akoma. Këtë e kam me shumë dyshim.

Arben Pëllumbi – Urdhëroni, zoti Bejtja!

Ilir Bejtja – Edhe një herë, për pjesën e pyetjes së parë, e cila lidhet me diferencat e blerjes dhe shitjes midis KESH-it dhe OSHEE-së, së pari, kur KESH-i i shet ato 1,5, që thoni ju, furnizon më parë OSHEE-në 100%. Pra, OSHEE-ja nuk blen gjatë periudhës që shet KESH-i, që ka prodhim 27 milionë kilovat/orë në ditë. Nuk blen absolutisht.

Ju faleminderit shumë që konstatooni që kemi shitur në atë periudhë me 45 euro, por nuk e shesim dot. Mund ta kemi shitur me 19-20 energjinë që kemi tepërcë nga marsi deri në qershor 2021, sepse është i gjithë tregu me aq.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Arben Pëllumbi – Ju lutem, mos ndërhyuni, zoti Bushati!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ilir Bejtja – Po merri dhe lexoji se sa është çmimi për çdo shitje!

(Deputeti Bushati diskuton pa mikrofon.)

Helidon Bushati – Jam duke diskutuar këtu për 40 milionë euro që do të paguajnë qytetarët shqiptarë.

Kur diskutojmë, duhet të diskutojmë me shifra. Këto janë shifrat, zoti Bejtja. Prandaj, kur vini në këtë komision, duhet të jetë drejtori i KESH-it. Këto janë shifrat, por do t'i rikthehem përsëri më vonë.

Arben Pëllumbi – Zoti Bushati, unë nuk di një moment që të mos jua kem dhënë fjalën kur e keni kërkuar. Këtu nuk jemi në kafe. Ju bëtë pyetjet tuaja. Lejojeni zoti Bejtja të përgjigjet, edhe pse, me të drejtë, zoti Beqiraj thotë se jemi jashtë rendit të ditës!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka mundësi ta përfundoj fjalën? Edhe pse nuk jemi brenda rendit të ditës, ju e konsideroni të rëndësishme ta bëni këtë diskutim. Zoti Bejtja po u përgjigjet të gjitha pyetjeve që ju keni. Besoj se, po ta kishte ditur këtë temë, do të kishte marrë edhe bllokun me shënime.

Pavarësisht faktit se cili nga ne ka më shumë letra apo di më shumë, këtu jemi në një seancë pyetjesh. Ju bëni pyetjet, përfaqësuesit përgjigjen. As ne nuk ua kontrollojmë pyetjet ju, as ju nuk ua kontrolloni përgjigjet atyre, prandaj ta vazhdojmë mbledhjen, siç e kemi bërë gjithmonë. Sa herë të doni, merreni fjalën, se nuk do të ikin të ftuarit, këtu do të jenë për t'iu përgjigjur pyetjeve tuaja, brenda mundësive që kanë.

Vazhdoni, zoti Bejtja!

Ilir Bejtja – Insistoj, dhe është e verifikueshme, ju ftoj të gjithëve (do t'ua sjell edhe materialin) të bëjmë edhe një transparencë, meqenëse zoti Bushati e kërkon. Gjatë periudhës mars-qershor, kur ne kemi ujë, të cilin nuk mund ta rezervojmë, shesim dhe është fat nëse ka ndodhur që në prill të kemi ato çmime, sepse ka raste që kemi shitur edhe me më pak se 10 euro. Në vend që ta hedhim ujin, e kemi prodhuar dhe e kemi shitur dhe është fat kur ndodh që në atë periudhë ne të kemi çmime të tilla. I bie që ne atyre duhet t'u japim një medalje ari “Bravo ju qoftë”, pra nëse kanë arritur që në atë periudhë të sheshin me ato çmime aq të mira sa thoni ju.

Nga ana tjetër, në atë periudhë OSHEE-ja nuk blen energji, sepse e konsumon të gjithë prodhimin e vendit. OSHEE-ja blen energji kur KESH-i nuk e plotëson nevojën e OSHEE-së me prodhim vendi dhe kjo fillon nga muaji korrik deri në dhjetor, muaj që shpeshherë është i thatë, njëlloj si nëntori, por, kur ka shira, prodhon KESH-i.

Pra, në të gjitha rastet OSHEE-ja blen vetëm kur nuk prodhon KESH-i. Që ta dini, edhe tepricën e merr po OSHEE-ja, e merr të gjithën dhe e ka marrë me çmim HUPEX-i, se kështu ka pas qenë, pra 3,95 terra i merrte me çmim 1,5 lekë dhe pjesën tjetër të energjisë që merrte nga KESH-i e merrte me EPEX, që mund ishte 39 euro, mund të ishte 40 euro, mund të ishte 50 euro, gjithmonë e vendosur si masë çmimi, kur ato blinin tepricën, e kanë blerë për humbjen, e kanë blerë për nevoja ekstensive, për çdo gjë.

Në situatën që jemi, nuk kemi të njëjtën ngjarje.

Së pari, OSHEE-ja është ndarë në tri ndërmarrje. Nuk është më OSHEE-ja që merr vendim për të tri ndërmarrjet, se ato duhet të operojnë të ndara, OSSH-ja duhet të garantojë

akses të barabartë të të gjithë operatorëve në treg dhe për këtë është edhe një program përputhshmërie bashkë me një zyrë përputhshmërie, të cilët verifikojnë çdo konflikt interesi, favorizim të ndërmarrjeve publike ndaj gjithë operatorëve privatë. Pra, nuk kemi më të njëjtën gjë.

Ajo që bëjmë ne tani, është pjesë e reformës së energjisë, të cilën jemi duke e kompletuar dhe për çdo veprim marrim një *no objection* nga sekretariati i komunitetit të energjisë, pra nuk veprojnë më vete.

Po e them edhe një herë, jemi shembull në këtë drejtim, se si jemi duke e menaxhuar sistemin, pa deformuar reformën gjatë kësaj periudhe shumë të vështirë energjetike në të gjithë Europën. Mund të kishte të tjerë që do ta kishin bërë ndryshe, por kundër reformës.

Sa për FTL-në, arsyeja për të cilën është krijuar FTL-ja, përtej të qenit *last resort*, derisa të krijohet operatori i energjive të rinovueshme për të thithur energjinë e HEC-ve të vogla, është që të garantojë çdo konsumator në tregun e lirë, i cili nuk gjen energji në tregun e lirë, të kthehet te FTL-ja dhe ta marrë me çmim të liberalizuar, sepse FTL-ja operon në treg të lirë.

Nga ana tjetër, nëse nuk do të ishte FTL-ja, furnizuesi i mundësisë së fundit, që është FSHU-ja, ka detyrimin me ligj që dy muaj pas një dite, pra i nxjerr një ditë në tregun e lirë, nuk gjejnë, kthehen ditën e dytë radhazi, plus dy muaj pambarim, t'i furnizojë të gjithë klientët me energji elektrike, prandaj edhe quhet furnizuesi i mundësisë së Fundit dhe, si i tillë, do ta deformonte totalisht reformën. Ne nuk do të kishim kurrë treg të lirë, kurrë liberalizim. Krijimi i operatorit të tregut të lirë bën të mundur që edhe enti publik, grupi OSHEE, të ketë në tregun e lirë një operator, i cili blen dhe shet me çmime të parregulluara. Ai ka të instaluar platformën e blerjes së energjisë, e cila shërben që të bëjë të gjitha blerjet për grupin. Pra, edhe blerjet për humbjet, kur ato duhen blerë, edhe blerjet në rastin kur KESH-i nuk prodhon energji për të plotësuar 3, 95-ën, që thatë ju, i bën nëpërmjet platformës. Ia ofron FSHU-së dhe OSSH-së si *outsources*. Nuk kanë ato platformë të blerjes së energjisë. FSHU-së nuk i lejohej të blejë energji me tender të thirrur, njëlloj siç blihen materialet. Blihen online. Platformën online e kemi të instaluar brenda grupit, në FTL.

Pra, funksioni i saj bazë nuk është ky, meqë ka platformën, të ofrojë shërbimin e blerjes së energjisë për FSH-unë dhe për OSSH-në. Ju garantoj se çdo konsumator në tregun e lirë do të gjejë energji patjetër. Kjo është arsyeja pse FTL-ja duhet të vazhdojë të ekzistojë. Është një operator, që ne e kemi vendosur për të pasur një prani shtetërore edhe në tregun e lirë, dikë që operon në tregun e lirë midis operatorëve shtetërorë.

Ky është vendim i yni. Ky ka qenë projekt i mbyllur që në vitin 2017, që në vijim është zbatuar me ndarjen, e cila ndodhi më 16 dhjetor të vitit 2019, me vendim të Entit Rregullator, pra kur u ndanë të tria ndërmarrjet. Ky proces do të vazhdojë akoma më tej, derisa të tria ndërmarrjet të mos kenë më shërbime *outsourced* të kryera nga mëma. Të mbarojmë krejt detyrimet e vjetra, që kemi trashëguar nga e kaluara, borxhet e çmendura të para 2013-ës, që kemi pasur, por të cilat i kemi ulur shumë. Kanë qenë 48 miliardë, ndërkohë që sot janë 7, 1 miliardë. Kaq kemi trashëguar ne nga privatizimi i famshëm, galopant, shumë i suksesshëm i shpërndarjes, që bëri PD-ja në 2009-ën. Pra, një gropë e tmerrshme. 1 miliard e 160 milionë dollarë debi e papaguar, 768 milionë dollarë *equity negative*.

Këto kanë qenë rezultatet që la PD-ja me privatizimin. Nuk është garë, nuk është target për ne të matemi me atë periudhë. Sot që flasim, të ardhurat mujore nga shitja e energjisë, vetëm në grupin OSHEE, i kemi 7, 8 miliardë lekë. Kaq arrijmë të shesim ne. 96 % e faturës korrente është e arkëtuar, 20 % janë humbjet. Në qoftë se këto janë gjëra, të cilat ju nuk doni t'i përshëndesni, të paktën le të mos i shajmë.

Pra, kjo është arsyeja përse e mbajmë FTL-në: që duhet të kemi një prezencë publike në tregun e lirë. Kjo për garanci furnizimi, asgjë tjetër. Ato operojnë në treg me çmim të parregulluar, shesin dhe blejnë. Ndërkohë KESH-i, për optimizim kaskade, mundet që brenda ditës të shesë e të blejë energji në treg pa kompromentuar furnizimin e OSHEE-së për pjesën e planifikuar të prodhimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, unë di se jo të gjithë këtu kanë background ekonomik dhe e kuptojnë çfarë do të thotë optimizim portofoli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

S'ka problem. Ja, e keni ju si detyrë t'ua shpjegoni të gjithëve.

Fadil Nasufi – Zoti Bushati, të mbarojë zoti Bejtja!

Ilir Bejtja – E para, nuk është optimizim portofoli, sepse ne nuk prekim në portofol, por bëjmë optimizim energjie, të cilën e përdorim për të rritur rezultatin financiar intraday në fund të vitit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull!

Pra, KESH-i nuk shet energji. Edhe më përpara KESHI nuk ka shitur asnjëherë energji, duke kompromentuar detyrimin prej 3, 95 terra, detyrim për furnizim që ka pasur ndaj grupit OSHEE.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po e them unë.

Ndërkohë, e gjithë teprica prej 1, 5 terra, që përmendët ju – kemi pasur më shumë se 1, 5 terra, kemi pasur 6, 1 terra prodhim – shitet në periudhën kur ne nuk kemi mundësi të prodhimit të energjisë. Është plotësuar 100 % nevoja e OSHE-së, ndërsa më pas shitja vazhdon të bëhet në treg. Kjo është me ligj, zoti Bushati, është e ndaluar. Tani ligjet po ndryshojnë. Me ligj e keni të shkruar. Në ligjin bazë të energjisë, KESH-i shet tepricat vetëm në rast se nuk ka nevoja nga OSHEE-ja. Këtë e ka vendosur Enti Rregullator. Pra, ne nuk shesim energji, por shesim teprica. Tani që flasim, KESH-i shet dhe blen, sipas vendimit të qeverisë për menaxhimin e prodhimit, që të garantojë 4, 6 terra për tregun e parregulluar dhe 5, 7 terra në total, së bashku me 1, 1 terra që i duhen tensionit të mesëm, depoziton, shet, blen në treg, në mënyrë që optimizojë kaskadën, që në fund të vitit rezultati financiar të jetë në mënyrë ekonomike, me sa më pak humbje, pse jo dhe me fitim. Viti që shkoi ishte vit me fitim. Kjo ngaqë patëm fat që çmimet u çmendën vetëm tre muajt e fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Bejtja!

Kush ka pyetje? Veçse, ju lutem të qëndroni te ratifikimi i marrëveshjes së huasë, për arsye se edhe zoti Bushati e hapi debatin pak më gjerë. Kjo edhe për shkak të menaxhimit të sistemit energjetik në përgjithësi, edhe për shkak të situatës së vështirë që po kalojmë si pasojë e krizës. Ka edhe mundësi të tjera për t'i parashtruar këto probleme. Ju lutem kolegë, duke qenë se sot kemi një marrëveshje dhe jemi komision për dhënie mendimi, kush e do fjalën?

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Zoti Bushati, e doni prapë fjalën? Po.

Helidon Bushati – Atëherë, e fillova diskutimin tim, ose më mirë të themi pjesën e parë të pyetjeve, me atë çfarë thoshte raporti i ERE-s, Entit Rregullator shtetëror për Energjinë, ku qartësisht tregohet se kaskada është keqmenaxhuar, domethënë në shifra, në cilësi e në sasi.

U mundova të qartësoj gjithë kolegët, edhe në lidhje me keqmenaxhimin financiar. I nderuari zoti Bejtja tha se çfarë bën shpeshherë KESH-i: bën optimizim portofoli. Ky është koncept ekonomik, pa dyshim. Shet dhe blen brenda së njëjtës ditë. Fatkeqësisht, duhet thënë

se KESH-i, në ndryshim nga çdo entitet tjetër normal në botë, shet dhe blen duke humbur vetë. Kjo është diçka e padëgjuar dhe abuzim i pastër. Zoti Bejtja jep datat 1 dhe 2 prill të 2021-shit, që i kemi këtu, ku shet 11. 800 mega me 150 euro...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...1 dhe 2 prill të 2022-shit, më fal, shumë e saktë, për një vlerë prej 3, 2 milionë euro dhe blen 11 mijë mega, pothuajse të njëjtën sasi, me 250 euro. Ka 1, 7 milionë të ardhura. Domethënë, vetëm brenda tre ditëve, me dy transaksione, KESH-i humbet shifrën e papërfillshme për këtë qeveri, shifrën prej 1, 5 milionë eurosh. Për dy ditë humbet 1, 5 milionë euro. Ky është optimizimi i portofolit: optimizim me humbje. Të gjithë kolegët e nderuar biznesmenë, që kanë një kompani, mundohen të dalin me fitim, sikundër është edhe objektivi i çdo kompanie, por jo...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem! Të lutem, zoti Bejtja!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, datat janë: 1 e 2 prill në shitje, ndërsa në blerje është 28 mars - 2 prill. Janë me ditë këto. Do t'ju jap, që t'i keni, se ndoshta drejtori i KESH-it, i cili duhej të ishte këtu, mund t'ju ketë keqinformuar edhe juve, pasi është bërë si praktikë pune që keqinformoni njëri-tjetrin, zoti Bejtja, me dy transaksione 1,5 milionë euro.

Thatë se ka pasur të ardhura vjetore prej 57 milionë eurosh. Bilanci në fitim në fund të vitit ka dalë 57 milionë euro. Meqenëse keni eksperiencë dhe jeni i fushës e dini se këtu KESH-i, për të mos shpërndarë dividendë, ka bërë tenderë ku kërkohej helikopter për të supervizionuar rrugë, ka qenë kriter që tenderimi të kishte helikopter, ndërkohë që tashmë përdoren dronët.

Zoti Bejtja, se mbase këtë të dhënë nuk e dini, vetëm në muajt shkurt-mars të këtij viti, te buletini i njoftimeve publike janë 50 procedura tenderimesh të KESH-it, ja ku shkojnë ato 57 milionë. Sidoqoftë, zoti Bejtja, unë mendoj se ka vend për hapjen e një komisioni hetimor sa i përket keqmenaxhimit të kaskadës. Unë do të ndërmarr ato hapa me forcën time politike, që të ngrihet ky komision për abuzimin e tmerrshëm që është bërë me kaskadën.

Ju faleminderit!

Ilir Bejtja - Është blerë energji në datën 25, për datat 28 deri më 31 mars, me 230 ose 250 euro (nuk jam fort i sigurt, duhet ta verifikojmë si shifër) për një periudhë ku ne kemi qenë me 256 metër në kaskadën e Drinit. Pra mundësitë për prodhim kanë qenë minimale, nuk ka pasur asnjë pikë shi në horizont, temperaturat kanë qenë shumë të ulta dhe deri në 700 metër lartësi kanë qenë nën 0 gradë. Pra, prurjet të Drin kanë qenë nën 100 metër kub në

sekondë. Mundësia që ne të garantonim furnizimin me energji në këtë periudhë, sepse jemi të angazhuar të mos mungojë fare energjia, është importi. Kjo blerje në import është e konstatuar edhe nga media, të njëjtin burim ka edhe zoti Bushati, që është 33 euro më pak se çmimi i bursës, ku kemi parasysh se bursa HUPX-it parashikon energji në burim pa kapacitete dhe për ta sjellë nga Hungaria në Shqipëri duhen edhe 60 deri në 70 euro plus kapacitete. Pra, e kemi blerë më lirë sesa bursa e Hungarisë, 230 me 30 euro më pak dhe, nga ana tjetër, sikur ne ta kishim në shtëpi, bashkë me kapacitetet, që po t'i heqësh edhe 70 euro, i bie që e kemi blerë me rreth 100 euro kursim.

Kjo është e verifikueshme. Unë e sfidoj zotin Bushati, që ta verifikojmë këtë, mundësisht të jemi edhe të filmuar, që të mos kemi mundësi ta themi ndryshe, sepse unë edhe rrej ndopak!

Në anën tjetër, është shitur energji në datën 28 për datat 1 dhe 2 prill, me 163 euro, kur për të njëjtat data bursa e HUPX-it është me 123 euro në bandë dhe 94 euro në pikë, sepse ka pasur prurje në të gjithë rajonin dhe në bursën EPEX SPOT, që është gjithë Europa Qendrore, ku përfshihen më shumë se 18 vende dhe 4 bursa të rëndësishme, ka qenë 157 euro. Pra, ne kemi shitur më shtrenjtë sesa këto bursa në vend për operatorë, që nuk e shesin energjinë në Shqipëri, por në vendet e tyre apo në vende të tjera, dhe po t'u shtosh edhe kapacitetet, i bie që kemi shitur shumë më mirë sesa ç'mund ta blinin atë diku tjetër. Pra, ne e shitëm më shtrenjtë dhe fituam nga shitja; blemë më lirë dhe fituam nga blerja. Nuk bashkohen dy data, që kanë në mes një *gap* prej rreth 4 apo 5 ditësh që nuk ka ujë, ne duam të pimë përditë, e duam energji përditë. Kur bëhet krahasimi, bëhet me çmimet *on-spot* në ditë, nuk bëhet krahasimi me një javë apo 3 ditë.

Po, zoti Bushati, dalim në treg çdo 3-4 ditë, që të kemi mundësi të ndjekim çmimet e tregut dhe të marrim çmimin më të mirë të mundshëm, ashtu siç kemi bërë edhe blerje afatgjata, me çmim mesatar në total 212 euro deri në qershor për çdo muaj me disa kapacitete nga 100 deri në 180 megavatë për orë.

Në të gjitha rastet kur ne kemi pasur më pak prodhim dhe nuk e kemi plotësuar me blerjen afatgjatë, na është dashur të dalim edhe në treg.

Për saktësi, kemi shitur jo 11, por 10 mijë e 800 dhe kemi blerë 11 mijë e 800, sa thatë ju. Pra, ne blejmë sipas kërkesës për energji ditore që ka KESH-i dhe në periudhën kur kemi blerë OSHEE-ja ka pasur një kërkesë për energji prej 21 milionë kilovatë/orë. Për datat 1 dhe 2 prill, kur kemi shitur, kërkesa nga ana e OSHEE-së është rreth 16 milionë e 500/700 kilovatë/orë. Pra, kemi pasur mundësinë të prodhojmë dhe kemi prodhuar në Koman, në Vaun e Dejës, ku ne nuk mbajmë dot ujë, pasi nuk kemi rezervë atje. Atje mund të operojmë

vetëm në një segment prej 3 deri 3,5 metër prej secilin prej baseneve, ndërkohë që nga data 1 prill që e kemi të mbyllur totalisht Fierzën. Pra, nuk prodhojmë në Fierzë, por rikuperojmë kapacitetet. Sot që flasim kemi shkuar rreth 276,5 metër.

Pretendimi ynë është që deri në fund të muajit të jemi mbi 280 metër në kaskadën e Drinit dhe shpresojmë që moti do të jetë bujarë me ne që deri në fund të qershorit të rikuperojmë atë 297-metërshin e famshëm, që e kemi bërë çdo vit kur ka pasur mundësi që të ketë prurje.

Ju nuk morët vitin 2020, që ne prodhuam vetëm 2,6 terravatë dhe qemë fat që energjia është shitur me 31 -32 euro në bursë dhe patëm mundësi të menaxhojmë një burim me të vërtetë shumë të varfër ujqor që kishim, për të menaxhuar që të mos kishim kosto as në KESH dhe as në OSHEE, edhe pse ishte vit pandemik dhe ndryshoi totalisht raporti i konsumit. Mbi 62% e energjisë në vitin 2020 u konsumua nga familjarët, të cilët blejnë energji sot me 1,22 lekë më pak sesa kostoja e shpërndarjes së energjisë elektrike dhe këtë arritëm ta menaxhojmë shumë mirë.

Edhe këtë vit ne projektojmë të dalim me sa më pak humbje, i gjithë sistemi, nuk bëhet fjalë që të kemi fitime. Zoti na ruajt, nëse do të bëhet ndonjë kataklizëm, të kemi 8 terravatë prodhim, të bjerë shi të gjithë vitin, do të ishte keq për turizmin, ndërkohë që të kishim mundësinë që të mos blinim asnjë kilovat energji!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk hapim tenderë, bëjmë tenderë vetëm për blerje energjie, asgjë tjetër. Këtë e bëjmë çdo tri ditë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk jemi aq të zotët! Që të bësh një tender duhen të paktën 45 ditë së bashku me periudhën e kundërshtimit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk shpallen dot, se duhet të ecësh me para në bankë. Nuk e kuptoj si e ke këtë stilin e tenderit! Duhet të kesh para në bankë që të shpallësh tenderin. Kaq, është e thjeshtë fare.

Fadil Nasufi – Të lutem, qëndroni te marrëveshja!

Zoti Bushati me ligj ka të drejtën të kërkojë interpelancë, të ngrejë komision hetimor. Këtu je për marrëveshjen!

Ilir Bejtja - Nga ana tjetër, kjo marrëveshje, siç thashë, është brenda parametrave ekonomikë, e shlyeshme, e likujdueshme, nuk rëndon mbi rezultatin e KESH-it, përkundrazi, rrit eficiencën dhe na jep disa kursime, përtej garancisë që ne do të kemi prodhim të vazhdueshëm të energjisë.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Bejtja!

Ka pyetje ose komente nga kolegët?

Po, zoti Duraj.

Laert Duraj – Përshëndetje të gjithëve!

Besoj se është e qartë për të gjithë që menaxhimi i situatës hidrike në përgjithësi këto vitet e fundit ka pësuar jo vetëm një qasje ndryshe me OSHEE-në, e cila është ndërmarrje publike, por edhe me rritjen totale të efikasitetit. Jo vetëm kaq, por edhe vizioni i qeverisë sonë, sidomos për ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës, i cili do ta rrisë shumë efikasitetin e menaxhimit të burimeve hidrike, është në funksion edhe me kërkesën që është paraqitur pranë komisionit tonë për ratifikimin e marrëveshjes së huas.

Unë besoj se, sidomos nën dritën e re të zhvillimeve ndërkombëtare, ku kriza, sidomos ajo e energjisë, është fakt dhe ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në jetët tona, si dhe të pasurit e një pavarësie hidrike energjetike në këtë rast me një efikasitet shumë të madh është në interesin e të gjithëve. I kuptoj shumë mirë kolegët e opozitës në lidhje me shqetësimet që kanë pasur, pasi situata ka qenë e tillë, kjo si rezultat i një viti jo i mbarë sa u takon reshjeve, ndaj në fokus të veprimtarisë së komisionit për ditën e sotme është kjo kontratë, e cila sipas gjykimit dhe mendimit tim duhet të kalojë sa më shpejt që të jetë mundur për të filluar puna, sepse jo vetëm që është një *deal* i mirë, por edhe për faktin se çdo ditë që kalon ne nuk e dimë se si do të shkojë puna e kostove të investimeve dhe ndoshta këto mund të ndikojnë jo mirë në këtë histori.

Unë besoj në efikasitetin dhe racionalitetin e zgjedhjes së projektit në këtë kohë, prandaj i ftoj kolegët që ta votojmë dhe ta kalojmë projektligjin sa më shpejt që të jetë e mundur.

Faleminderit!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zoti Duraj!

Po, zoti Beqiraj.

Ismet Beqiraj – Jo, nuk është çështje për politikë këtu.

Me thënë të vërtetën ky ishte një diskutim shterues. Ne kemi nevojë, sepse është më mirë kur shkojnë vetë te kompanitë, edhe te kompanitë e kolegëve që i kemi këtu, duke u nisur që nga Agroni, Zefi, Tatjana e të tjerët me radhë, për t'i parë gjërat me sy dhe të flasim kur i thonë me këmbë në tokë, duke mos sjellë në mbledhjet e komisionit deklaratat e asnjë force politike që ne i përkasim.

Pavarësisht se këtu u diskutua gjatë dhe unë ndërhyra, sidomos gjatë pyetjeve me kolegun tim Bushati, sigurisht i mbetem faktit për të marrë një informacion më të plotë dhe

më të detajuar, sepse jo të gjithë jemi specialistë të fushës dhe jo të gjithë e kemi perceptimin e punës reale që është bërë në OSHEE dhe në gjithë sistemin elektroenergjetik shqiptar.

Ky është një lajm i mirë për të gjithë ne sot, që financimi prej 40 milionë eurosh, të cilin do ta ratifikojmë në Kuvend, sikurse u tha edhe nga zoti Bejtja, do të mbyllë ciklin e rinegjërimit total, edhe me teknologji të re, të kaskadës së Drinit. Nga ana tjetër edhe fakti që projekti deri në kohën e shfrytëzimit, sikurse e tha edhe Helidoni, por unë nuk jam specialist i fushës, janë 30-40 vjet dhe do t'i shtohen edhe 30 vjet të tjera do të thotë që Shqipëria është e sigurt dhe ne pothuajse do të jemi vendi i parë në botë që do të përdorë energji të rinovueshme ku furnizimin e bazojmë në energjinë elektrike, hidrike deri në masën 97%.

Do të isha kurioz të dija që në konsumin total të energjisë së vendit, nuk e kam si pyetje: sa kontribut jep prodhimi i energjisë elektrike me sistemin hidro?

(Diskutime pa mikrofon)

Sa?

(Diskutime pa mikrofon)

35,2%.

Unë këtë e quaj lajm shumë të mirë që e gjithë kjo kaskadë po rehabilitohet teknikisht duke iu zgjatur jeta, përveç benefiteve të tjera që jepen.

Në mbyllje, kam edhe një koment. Ne nuk kemi pse të presim deri sa të na vijë ndonjë projektligj për të diskutuar me kolegët e ministrive përgjegjëse të fushës, prandaj do t'i kërkoja kryesisht të komisionit, siç e kërkoja dje edhe sot që të planifikojë vizita, pra jo në mënyrë virtuale dhe me opinione, por të jemi atje në vend ku bëhet puna konkrete, madje të organizohet edhe një takim me drejtuesit e këtyre kompanive të rëndësishme energjetike që sigurojnë stabilitet, ekonomi dhe garanci energjetike për vendin që të mos ngelemi peng të rrjeteve dhe të komenteve politik dhe të atyre që nuk thonë kurrë një fjalë të mirë. Unë e kam thënë edhe më parë kur është diskutuar kjo gjë, ta ngresh nga ferri KESH-in dhe ta dërgosh në këtë kohë ku edhe në fshatin më të thellë po futet sistemi kabllor...

(Diskutime pa mikrofon)

Helidon, ke folur sa ke dashur edhe jashtë orbite, por këto janë të vërteta që ndikojnë direkt te humbjet...

Helidon Bushati – Elektrifikimin e bëri partia, ju po bëni...

Fadil Nasufi – Ju lutem, përmbylleni diskutimin!

Ismet Beqiraj – Zoti Helidon, ne, gjatë këtyre 9 vjetëve, kemi kuruar të gjitha plagët dhe mëkatet që la qeverisja juaj në 2013-ën.

Helidon Bushati – As kaskadën nuk arritët ta bënit për 8 vjet, as të gjithë sistemin nuk arritët ta bënit...

Fadil Nasufi – Zoti Mziu, një sekondë.

Unë besoj që diskutimet në lidhje me këtë projektligj shteruan.

Kalojmë në procesin e votimit.

Do të hedh në votim në parim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë (huamarrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare KESH (Agjencia e zbatimit të projektit) dhe KFW Frankfurt am Main (KFW), për rehabilitimin e hidrocentralit të Fierzës”.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Kush është dakord me nenin 1? Kundër? 4 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord me nenin 2? Kundër? 3 kundër. Abstenim? 2 abstenim.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? 5 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Projektligji miratohet.

Mbledhja mbyllet.

Mirë u pafshim javën tjetër, sipas agjendës!

MBYLLET MBLEDHJA